

VENDIM
Nr. 248, datë 13.12.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 110, DATË 26.4.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 35, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘BIOPOWER GREEN ENERGY’ SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/6 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “*Biopower Green Energy*” sh.p.k, për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 26.4.2021, ndër të tjera vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “*Biopower Green Energy*” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.

- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 110/2021, shoqëria “*Biopower Green Energy*” sh.p.k. ka përcjellë argumente dhe dokumentacion, në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi. Shoqëria ka depozituar korrespondencën e zhvilluar mes saj, AIDA-s (Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në komunikimin e fundit të datës 7.12.2020, AKM-ja konstaton se aplikimi i shoqërisë “*Biopower Green Energy*” sh.p.k. do të merret në rishqyrtim pas plotësimit të këtyre dokumenteve/informacioneve të munguara.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit nr. 110, datë 26.4.2021.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s, nr. 77, datë 9.11.2021, në datën 23.11.2021, ishte planifikuar për t’u zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “*Biopower Green Energy*” sh.p.k. (seancë e cila, në bazë të kërkesës së vetë shoqërisë u zhvillua në datën 2.12.2021).

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 110/2021, që ka të bëjë me lejen e mjedisit, shoqëria ka bërë me dije se nga takimet me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), doli në pah se për të vijuar me aplikimet, sipas procedurave ligjore, duhet të merret më parë autorizimi paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Pa autorizimin paraprak të MIE-s, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) nuk mund të pranojë aplikimin për leje mjedisore, i cili sikurse dokumentohet edhe më herët në ERE është bërë dy herë dhe është refuzuar për arsyen e sipërcituar. Në këto rrethana, shoqëria është shprehur se po procedon me aplikim pranë MIE-s, që më pas të mund të aplikojnë sërish pranë MTM-së për t’u pajisur me leje mjedisore. Bashkëlidhur shoqëria ka përcjellë në ERE shkresa të cilat lidhen me ecurinë e zbatimit të hapave për të realizuar projektin eolik, në kuadër të statusit të investitorit strategjik. Në vijim të sa depozitohet, në seancën

dëgjimore shoqëria mbajti të njëjtin qëndrim dhe ka deklaruar se është e detyruar t'i nënshtrohet kërkesave të autoriteteve përkatëse, në lidhje me marrjen e të gjitha lejeve dhe autorizimeve për të vijuar me zbatimin dhe vënien në punë të projektit eolik, kjo edhe në kuadër të Statusit të Investitorit Strategjik, me të cilin është pajisur. Në këto rrethana, shoqërisë iu kërkuar të qartësojë/saktësojë marrëdhënien e saj me ERE-n, në kuadër të mbajtjes ose jo të licencës që disponon. Përfaqësuesi i shoqërisë deklaroi se në vijim do të merrte pjesë në një takim me MIE-n, në kuadër të pajisjes me miratim paraprak dhe se në këto rrethana ishte i paqartë për të përcaktuar vazhdimësinë ose jo të licencës së lëshuar nga ERE. Për sa bëhet me dije nga shoqëria, iu kërkuar kësaj të fundit, që në takimin me MIE-n të qartësonte statusin e saj dhe të informojë ERE-n në lidhje me angazhimin e saj, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit e, rrjedhimisht nëse do të vazhdojë marrëdhënien me ERE-n në kuadër të licencës që disponon. Në rrethanat kur shoqëria nuk ka kthyer ende një përgjigje për sa kërkohet në seancë, por duke marrë në konsideratë të gjitha përpyekjet e bëra nga ana e saj për t'u pajisur me leje mjedisore, si një nga kushtet e vendosura nga ERE, vlerësohet të zgjatet më tre muaj vendimmarrja e ERE-s, për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të informojë ERE-n në lidhje me statusin e saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe plotësimin e kushteve respektive të vendimit të licencimit.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit nr. 110/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, ka depozituar në ERE fatura blerje dhe shitje, si edhe dokumente bankare, të cilat bashkëngjiten faturave si provë. Sa më sipër rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion në plotësim të këtij kushti, por ERE rezervon të drejtën për t'u shprehur, pasi shoqëria të qartësojë statusin e saj. Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 5, të vendimit nr. 110/2021, që ka të bëjë me përditësimin në mënyrë periodike në ERE mbi statusin e realizimit të planit të veprimit, në zbatim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021, shoqëria ka depozituar në ERE informacion në lidhje me ecurinë e realizimit të këtij plani, ku sqaron se afati i statusit është deri në datën 4.2.2023. Gjithashtu, shoqëria ka shpjeguar se me qëllim respektimin e zonave të mbrojtura, është parë i vlefshëm spostimi i dy turbinave. Po ashtu është paraqitur dhe një raport vëzhgimi i rrugëve të transportit për projektin Shëngjin dhe Balldren. Në bazë të parashikimeve dhe të marrjes së të gjitha lejeve dhe autorizimeve përkatëse, shoqëria parashikon vendosjen në punë të centralit brenda majit të vitit 2023. Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion në plotësim të këtij kushti, por ERE rezervon të drejtën për t'u shprehur, pasi shoqëria të qartësojë statusin e saj.

- Me qëllim qartësimin e statusit të saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe plotësimin e kushteve respektive të vendosura në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110/2021, vlerësohet që të zgjatet afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 3 (tre) muaj për shoqërinë *"Biopower Green Energy"* sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e vendimmarrjes së ERE-s për plotësimin e kushteve të vendosura në vendimit nr. 110, datë 26.4.2021.

2. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, shoqëria *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. të qartësojë statusin e saj referuar licencës me të cilën është pajisur nga ERE dhe kushteve përkatëse.

3. Shoqëria *"Biopower Green Energy"* sh.p.k. të informojë/dokumentoje në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi apo aktet ligjore, apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë kërkuuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti